

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vjollca Kurtishaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.E. nga fshati ...Komuna e Shtimes, për shkak të kryerjes së veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.1118/2016 të datës 12.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.09.2018 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.1118/2016 të datës 12.06.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr. P.nr.1118/2016 të datës 12.06.2018, të akuzuarin V.E., e ka shpallur fajtor për veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose naloge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 200(dyqind)€, të cilin dënim do ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I akuzuari është obliguar që në afat prej 15 ditësh ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 15€. Të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues, konfiskimi i substancës narkotike të llojit marihuanë, në peshë prej 0,7 gram.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka parashtruar Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal të shqiptuar, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket sanksionit penal dhe të akuzuarit ti shqiptojë dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej tre muajve..

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.924/2018 më datën 30.08.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë dhe përgjigjes në ankesë, gjeti se:

**- Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 12.06.2018 e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal, me ankesë Prokurori pretendon se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka shqiptuar një dënim i cili nuk është proporcional dhe adekuat me peshën e veprës së kryer dhe se dënimi i shqiptuar nuk mund të ndikojë te i akuzuari e as te personat tjerë.

Duke vlerësuar çështjen përkritazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e Prokurorit për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar faktin se këto vepra penale në kohë të fundit janë bërë dukuri shumë e shpeshtë.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante të vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në fakt në ankesë nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i rëndë nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Pra, duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat tjera, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht

asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim më dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.918/18 me datë 25.09.2018**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
Vjollca Kurtishaj

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**

**1. Gani Zabeli**

**Anëtarët e kolegjit:**

**2. Shqipe Qerimi**

**3. Afrim Shala**